



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.913/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada Gillogjani anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lart Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Pejë, Rexhep Kurtbogaj nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Pejë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Rexhep Kurtbogaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal Pejë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me shenjen ZL.Anr.913/2017 të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.11.2017, nga Rexhep Kurtbogaj, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Pejë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Pejë me të cilën ka pretenduar se janë manipuluar votat e tij dhe kandidatëve tjerë të subjektit Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në qendrën e votimit 1709c në shkollën “Pjetër Budi” në komunën e Pejës. Parashtruesi i apelit thekson se në ditën e procesit zgjedhor të mbajtur më datë 22.10.2017, është informuar nga vëzhguesi subjektit politik LDK se në këtë qendër të votimit ka pasur parregullsi nga ana e komisionerëve në të gjitha dhomat e vendvotimit me të cilën dyshohet për keq regjistrim në formular me qëllim të favorizimit të një kandidati. Fletregjistrat në vendvotimin 1709c/02B, 1709c/01R, 1709c/03D të dhënat janë të dëmtuara dhe të paqarta. Apelit ia ka bashkangjitur disa deklarata të votuesve dhe një vëzhguesi.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazeshmeris së apelit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar.

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve në apel gjeti se parashtruesi i apelit nuk ka bashkangjitur dëshmi lidhur me pretendimet e parashtruara në apel. Prandaj, apelin e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotëson kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar dhe si të tillë apelin e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.913/2017 më datën 12.11.2017.



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*